

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ne të gjithë së bashku kemi bërë të pamundurën në emër të interesit publik që të hedhim dritë mbi një aferë të një grabitjeje të padëgjuar sa u takon shifrave dhe kurajës së çmendur të detyrimeve në të cilat kanë hyrë e nuk dalin dot dhe që jua kërkojnë ta çojnë përpara me nxitim. Kushdo që na dëgjon e para gjë që do të thoshte dhe do të pyeste do të ishte: çfarë është ky ngut kaq i madh për gjithë këtë sasi të madhe parash që janë në lojë dhe për gjithë këto interesa kaq të mëdha? Cila do të ishte përgjigjja e vetme, e mirë, shteruese, e qetë, pa propagandë, pa përralla dhe fantazira? Do të ishte transparenca deri në fund e çdo elementi.

Boll që salla e parlamentit për një nga investitorët ka marrë përgjigje nga ministrja, në fakt, ajo nuk mund të japë informacion se është konfidenciale, po atëherë çfarë dreqin duan që kërkojnë votën e parlamentit shqiptar kur këto qenkan të fshehta edhe për parlamentin? Le ta marrë vetë qeveria dhe ta çojë deri në fund këtë punë dhe mos ta sjellë në sallën e parlamentit. Çfarë shkarkon këtu? Shkarkon te vota politike e papërgjegjshme e maxhorancës përgjegjësi kaq të rënda. Sepse nuk mund të ekzistonte për një investim miliarda e miliarda, të cilit nuk i dihet se kush është në lojë, çfarë roli ka, kush janë pronarët dhe aksionerët dhe në dorë të kujt vete e gjithë kjo pronë e shqiptarëve? Pra, e gjitha është në dorë të aferave dhe të mafiozëve që e qeverisin aferën nga jashtë dhe nga brenda.

Këtu, shpeshherë, për të bërë një kapërcim shumë të shkurtër, flitet shumë për Europën dhe për përgjegjshmërinë e madhe që duhet të ketë opozita në raport me Europën lidhur kjo edhe me një eveniment që do të zhvillohet në Tiranë. Të gjithë shqiptarët pyesin për këta zemërcjerrët e Europës, këta që vdiqën për Europën, këta që u rrokanisën kokën njerëzve, duke u folur në emër të Europës. Po mirë, pse nuk e dëgjoni Europën kur ajo ka rezerva të mëdha për portin e Durrësit dhe e thotë shqip se ajo e shkel Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, për të gjithë ata që nuk e kanë atë kulturën e duhur, është guri i themelit mbi të cilën ecën procesi i integritit evropian?

Pse nuk e dëgjoni Europën kur thotë mos e bëni amnistinë fiskale, ju zemërcjerrët e Europës? Pse nuk e dëgjoni Europën për ligjin e medias, aq sa e detyruat të shkojë vetë në Strasburg, sepse jeni aq të çmendur saqë doni ta çoni përpara? Pikërisht për këtë projekt pse nuk e dëgjoni Europën ju kur thotë: jo me pasaportat e arta se rrezikoni liberalizimin e vizave të shqiptarëve, gjë, të cilën mezi e kanë arritur dhe nuk është vepra juaj? Ju lobonit, ca syfjet në këtë sallë kanë qenë që lobonin me personazhe që të votonin kundër liberalizimit të vizave, i dini shumë mirë këto, si dhe vinit kujën që do të iknin 2 milionë shqiptarë. Pse nuk e dëgjoni Europën, e njëjta Europë është? Pse nuk e dëgjuat Europën kur u ngritën të gjithë dhe thanë: mos e shembni Teatrin, ju zemërcjerrët e Europës?

Europa ju mban nën vëzhgim të tmerrshëm dhe ju thotë kujdes, sepse vazhdoni të jeni në Listën e Zezë të pastrimit të parave, prandaj mos bëni këtë, atë dhe atë. Pse nuk e dëgjoni Europën, ju zemërcjerrët e Europës? Pra, e gjithë kjo histori është fillim e mbarim historia e një demagogjie pa fund që nuk ka asnjë lidhje me realitetin. Është një investim strategjik më i madhi në vend, i cili në radhë të parë ka turizmin në zemër të këtij procesi që do t'i japë shtysë dhe do ta çoj përpara. Nga fillon ky turizëm? Fillon me ndërtim pallatesh? Gjeneri të tjerë budallenj për të gënjyer, sepse populli shqiptar nuk është popull që nuk kupton, ai e di dhe e ka shumë të qartë se nga fillon turizmi dhe nga se zhvillohet.

Nuk zhvillohet nga pallatet me pallate fillohet. I keni thënë vetë, nuk po i shpikim ne, nuk është nga ne, por nga dokumentet që janë të shkruara, siç e thotë edhe populli shatra-patra, aq sa edhe numrat brenda pjesës ekonomike, qoftë edhe në planet e menaxhimit financiar që keni prurë, edhe mospërputhjet, edhe gazetarët e zakonshëm, ua kanë zënë rrugëve, por, në fakt, nuk duhet të lëvizte as presja. Janë fakte publike e zeza në të bardhë, të gjithë duhet të skuqeshin dhe me vrap duhej ta merrnin mbprasht dhe ta shihnin nga themeli. Nuk janë shifrat e mia, janë tuajat. Pra, shteti, thënë thjesht, e fillon investimin gjigant strategjik si investitor pallatesh, investon shteti disa pallate, janë edhe mjaft biznesmenë privatë që ndërtojnë atje në Durrës, por ata nuk e kanë fatin që kanë këto pallatet e shtetit, sepse atyre u duhet të paguajnë edhe 7% taksa, pra këta janë të përjashtuar.

Kemi pallate të shtetit që i do shteti dhe ua zbret taksat dhe ata investitorët që merohen dhe që sakrifikojnë atje për të ndërtuar e kanë taksën 7%. A ma shpjegoni dot këtë strategjinë e turizmit që fillon nga pallatet dhe më pas do të vazhdojë me një marinë të vogël? Ju e kuptoni që është e vogël, sepse thuhet që 280 jahte janë, por njerëzit nuk kanë nevojë të lodhen shumë se ja ku e kanë Malin e Zi dhe e kuptojnë se çfarë niveli kanë marinat për të qenë kaq strategjike, të mëdha dhe të padëgjura, e paparë kjo në 30 vjet, duke mahnitur dynjanë. Më pas ka edhe një problem tjetër shumë të madh, kjo

është një portë hyrëse tregtare, themeli i gjësë, sepse janë miliona tonë mallra që do të transportohen dhe do të shkojnë në një port të ri, i cili do të bëhet nga Autoriteti Portual, thënë nga ju, jo nga ne.

Sa e ka fitimin në vit Autoriteti Portual? Në rastin më të mirë 5 deri në 6 milionë euro. Këtë portin që do të bëhet dhe që shkon në miliarda, me ato 5 apo 6 milionë euro do ta bëjë? Gënjeni, po gënjeni pak me dinjitet, sepse kjo është të jesh i paturp fare në gënjeshtër. Këto janë shifrat kokëforta. Ku do të shkojmë? Ku është porti? Ku do të ndërtohet? I ha njëri këto budallallëqe? Këto janë shumë të trasha, janë si ajo puna e lugës së floririt që do të hanim dhe përfunduar te tallonat. Do të ketë fillime të hekurudhave të mëdha, do të ketë portale e të tjera. Ku janë të gjitha këto, ku e kanë datën dhe ditën? Çdo ditë në port është para, se transportohen miliona, kështu që ato që nuk transportohen këtu do të ikin në porte të tjera, se ka alternativa.

Kur të kujtohen dhe të vijë ajo dita e mbrame që do të kemi këtë portin, bizneset do të kenë gjetur sistemime të tjera dhe do të kenë krijuar rrugë të tjera tregtare dhe Shqipëria do të përjashtohet prej tyre. Për çfarë? Vetëm e vetëm që të shisni portin e Durrësit dhe të merrni paratë për të bërë pisllekun e radhës. Ku është porti i mallrave? Para se të diskutoni 12 mijë apartamentet edhe 12 mijë të tjerat që do t'i blejnë me pasaportat e arta, se vetë i shkruani, nuk i shkruaj unë, në radhë të parë gjëja më kryesore mbi të gjitha do të ishte porti i mallrave. Si do të jetë? Kur do ta kemi gati? Çfarë po ndodh me të? Hekurudhat imagjinare kur do të ndërtohen dhe kur do të bëhen realitet? Asnjë nga këto nuk ekziston.

Unë po ju pyes nga Kuvendi i Shqipërisë, besoj se këtë pyetje po ua bëj drejtuesve të Kuvendit, që në datën 15 gusht të këtij viti 3 muaj e gjysmë më parë i kam bërë një kërkesë me 12 çështje për informacion ministrisë përkatëse dhe për dijeni Kryeministrit: Pse, ende sot e kësaj dite nuk kam marrë përgjigje? Ishin pyetje, të cilat shtronin çështje themelore që kishin të bënin me portin e Durrësit. Çfarë ndodh? Më e pakta në emër të transparencës duhet të kishte një përgjigje, sepse pyetjet nuk ishin as me detaje ultraspecifike, por në parim tregonin se si vendosej kjo çështje në raport me të mirën e përgjithshme. Nuk ka asnjë përgjigje. Kush ka frikë nga transparenca?

Ai që ka një qëllim jo të pastër, por të pistë, sepse ai që ka transparencë, në emër të respektit edhe ndaj këtij Kuvendi, i cili ndonjëherë ka paturpësinë të flasë për procedura, të cilat nuk i respekton asnjëherë, duhej ta kërkonte dhe të ishte në këmbë që kjo transparencë të bëhej për deputetët e Kuvendit që kanë dy mundësi për t'u informuar falë statusit që kanë dhe ligjit për informim. Asnjë informacion, sepse urdhri ka qenë mbajeni në grusht informacionin, kemi 70 e ca vota na mjaftojnë, të ecim përpara, ta lëmë shkatërrimin të dalë ku të dalë dhe le të vijojë gjëmadha, sepse ne e kemi mbaruar punën tonë

dhe çfarë kishim për të bërë. Do të thonë, ne i filluam pallatet, ndërkohë që do ta lënë Shqipërinë pa port, pa asnjë gjë dhe në mes të katër rrugëve, duke ia lënë në dorë pronën më të madhe të vendit njerëzve që nuk ua as dimë emrin, as kapitalin, asgjë.

Kjo ju bën të jeni shumë të qetë dhe të votoni me kënaqësinë më të madhe, që po e lëmë azat, por në emër të dikujt do të fitojë shumë. Në fund, “U tund mali dhe polli një mi”, nga 2,1 miliardë që duhet të vinin, do të vijin vetëm 6,8%, rreth 160 milionë euro. 80 milionë euro i ka ky pareliu i madh dhe 80 milionë euro i merr nga bankat. Kjo është mrekullia multimiliardere e portit të Durrësit; një çështje që nuk mbyllet sot, pavarësisht këtij votimi, sepse është një gjëmë e madhe, që shqiptarët nuk do ta pranojnë kaq lehtë, siç mendoni se do ta kaloni ju.